

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"Orient Kubz Construction" sh.p.k**

Ne Tirane, sot me datë 27.07.2024 une **Blerim Iballi** i identifikuar me nr **I835160002S**, themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuara **"Orient Kubz Construction" shpk**

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Ortaku themelon një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte **" Orient Kubz Construction" sh.p.k**

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

**4.1 Veprimtaria e Shoqerisë " Orient Kubz Construction" sh.p.k**

do të ketë për objekt :

Zhvillimi i projekteve te ndertimit, ndertimi i objekteve te banesave dhe jo vetem, ndertimi i rugeve dhe autostradave, ndertimi i hekurudhave mbi dhe nentokesore, ndrtimi i urave dhe tuneleve, ndertimi i tubacioneve dhe kanalizimeve, ndertimi i sherbimeve publike per energji elektrike dhe telekomunikimi, ndertimi i projekteve te ujit, ndertimi i projekteve te tjera te ndertimit civil, instalime elektrike, hidraulike, punime suvatimi, punime nga druri dhe materiale te tjera, blerja dhe shitja e pasurive te patundeshme, qiradhenia dhe menaxhimi i tyre, aktivitete te arkitektures, testim teknik dhe analizat, aktivitetet e specializuara te dizajnit.



4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe perdore financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.

4.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të administratorit.

#### **Neni 5 Selia**

**Rruga Qemal Stafa, Pazari i Ri, Pallati Skaj, Kulla1, kati tregtar 2, Tirane**

#### **Neni 6 Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore

#### **Neni 7 Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë 200,000 Euro ( 20,000,000) Leke.  
Kapitali do të ndahet në 1(nje ) kuot.

#### **Neni 8 Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.

Administator i shoqërisë do të jetë:



1. **Blerim IBALLI** person me shtetesi kosovare mbajtese i kartes se identitetit me nr  
I 83516002S

**Neni 9**  
**Viti financiar**

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

**Neni 10**  
**Te ardhurat neto**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

**Neni 11**  
**Juridiksioni**

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar , eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet rregullisht nga ortak themelues.

**Ortaku i vetem i shoqerise**

**Blerim IBALLI**

BLERIM IBALLI  
*Blerim Iballi*